




Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	26.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2427/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.302/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.1127/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.54/2020 të datës 26.02.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë pune: të çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.04.2022 mori këtë:**

**V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.54/2020 e datës 26.02.2020 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 27.06.2017 i punësuar në pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Komunë ne Lipjanit në kuadër Drejtorisë për Administratë me datë 31.01.2020 ka bërë kërkesë në Komune e Lipjanit për kompensimin e ushqimit gjatë punës sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Ndërsa, Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit me datë 24.02.2020 i ka kthyer përgjigje ankuesit në kërkesën e tij të datës 31.02.2020.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 24.02.2020 të Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit me datë 26.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 511/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 04.03.2020, me numër protokollit 552/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Lipjanit, ndërsa me datën 12.03.2020 nëpërmjet e-maili i cili është protokolluar me numër protokollit 673/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Lipjanit, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 14.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për





## Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1127/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 14.05.2020 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 26.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.02.2020 me numër protokoll 511/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja e zyrës së personelit të Komunës së Lipjanit e datës 24.02.2020; Akt emërimi i datës 27.06.2016; E-maili i datës 26.02.2020; E-maili i datës 12.03.2020 më numër protokoll 673/2020; Kërkesa e datës 30.01.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë analizimit të provave dhe fakteve të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi me datë 24.02.2020 ka pranuar përgjigjen e zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit, kundër së cilës i njëjti ka parashtruar ankesë me datë 26.02.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa në bazë të provave të lëndës është konstatuar se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me arsyetimin se i njëjti është shfuqizuar, mirëpo në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit në Këshill ka qenë duke u zbatuar Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar pasi që nuk i ka shterë mundësitë ligjore brenda institucionit ku punon, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 81 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: *“1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë; 2.Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1.Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrë”*.

Po ashtu edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nenit 16 paragrafit 4 është përcaktuar se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”*, ndërsa me shkresat e bashkangjitura ankuesi nuk ka sjellë asnjë dëshmi apo provë që para parashtrimit të ankesës së datës 26.02.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ketë parashtruar fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Lipjanit, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.302/2022**

**Flakron GASHI**



*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Eshref SHABANI**



*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Lipjanit;*
- *Menaxherit të Personelit në Komunën së Lipjanit;*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*